



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. 541 prot.

Tiranë, më 24.02 2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2142/1, DATË 17.09.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR, TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA PRO- PLAST SHPK, ME ADMINISTRATORË ZNJ. ANILA XHELI DHE ZNJ. AURELA BEQARAJ"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga shoqëria "PRO-PLAST" SHPK, nëpërmjet administratorëve të saj Anila Xheli dhe Aurela Beqaraj, nr. 660 prot., datë 24.03.2022, në të cilën ngrihen pretendime ndaj magjistratëve I.K., A.M., dhe F.K., me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, Durrës në kohën kur shkëlja e pretenduar dhe me vendimin nr. 2142/1 prot., datë 17.09.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitur nga Shoqëria Pro-Plast shpk, me administratorë znj. Anila Xheli dhe znj. Aurela Beqaraj", bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "ç", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Durrës, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Ish-Plastika, Shkozë, Durrës;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

